

**PHILIPS**

**Kufjet**

Seria **8000**

TAT8506



# Manuali i përdorimit

Regjistroni produktin tuaj dhe merrni ndihmë në  
[www.philips.com/support](http://www.philips.com/support)

# Përmbajtja

|   |                                                               |    |
|---|---------------------------------------------------------------|----|
| 1 | Udhëzime të rëndësishme<br>sigurie                            | 2  |
|   | Siguria e dëgjimit                                            | 2  |
|   | Informacione të përgjithshme                                  | 2  |
| 2 | Kufjet tuaja True Wireless                                    | 3  |
|   | Çfarë ka në kuti                                              | 3  |
|   | Pajisje të tjera                                              | 3  |
|   | Përmbledhje e kufjeve tuaja<br>True Wireless                  | 4  |
| 3 | Fillimi                                                       | 5  |
|   | Karikimi i baterisë                                           | 5  |
|   | Si vendoset                                                   | 6  |
|   | Lidhja e kufjeve me pajisjen me<br>Bluetooth për herë të parë | 6  |
|   | Çiftimi i kufjeve me një pajisje<br>tjetër me Bluetooth       | 7  |
| 4 | Përdorimi i kufjeve                                           | 8  |
|   | Lidhja e kufjeve me pajisjen me<br>Bluetooth                  | 8  |
|   | Kontrolli ANC (anulimi aktiv i<br>zhurmës)                    | 8  |
|   | Ndezja/fikja                                                  | 9  |
|   | Kontrollimi i telefonatave dhe<br>muzikës                     | 9  |
|   | Asistenti me zë                                               | 9  |
|   | Përdorni funksionin Voice Assistant<br>(nëpërmjet Google App) | 9  |
|   | Drita LED treguese e<br>kufjeve/kutisë së karikimit           | 10 |
| 5 | Rivendosja e parametrave<br>të kufjeve                        | 11 |
| 6 | Të dhëna teknike                                              | 11 |
| 7 | Njoftim                                                       | 12 |
|   | Deklarata e konformitetit                                     | 12 |
|   | Hedhja e produktit dhe e<br>baterisë së vjetër                | 12 |
|   | Heqja e baterisë së brendshme                                 | 12 |
|   | Pajtueshmëria me EMF                                          | 13 |
|   | Informacione mjedisore                                        | 13 |
|   | Njoftimi për pajtueshmërinë                                   | 13 |
| 8 | Markat tregtare                                               | 15 |
| 9 | Pyetje të bëra shpesh                                         | 16 |

# 1 Udhëzime të rëndësishme sigurie

## Siguria e dëgjimit



### Rrezik

- Për të shmangur dëmtimin e të dëgjuarit, kufizoni kohën që përdorni kufjet në volume të larta dhe vendoseni volumnin në një nivel të sigurt. Sa më i lartë të jetë volumni, aq më shkurtër është koha e dëgjimit të sigurt.

Sigurohuni të ndiqni udhëzimet e mëposhtme kur i përdorni kufjet.

- Dëgjoni me volum të arsyeshëm dhe për periudha kohe të arsyeshme.
- Bëni kujdes të mos e ngrini vazhdimisht volumnin ndërsa mësoheni me dëgjimin.
- Mos e ngrini volumnin aq shumë sa të mos dëgjoni çfarë ndodh rreth jush.
- Duhet të tregoni kujdes ose duhet të mos i përdorni përkohësisht kufjet në situata që mund të jenë të rrezikshme.
- Presioni i tepërt i zërit nga Kufjet mund të shkaktojë humbjen e dëgjimit.
- Nuk rekomandohet përdorimi i kufjeve me të dy veshët e mbuluar ndërsa drejtoni automjetin, dhe kjo mund të jetë e paligjshme në disa zona.
- Për sigurinë tuaj, shmangni shpërqendrimet nga muzika ose telefonatat ndërsa jeni në trafik apo në vende që mund të jenë të rrezikshme.

## Informacione të përgjithshme

Për të shmangur dëmtimin ose defektet:



### Kujdes

- Mos i ekspozoni kufjet në nxehtësi të lartë.
- Mos i hidhni në tokë kufjet.
- Kufjet nuk duhet të ekspozohen ndaj pikave ose stërkalave. (Shikoni vlerësimin IP të produktit specifik)
- Mos i lejoni kufjet të zhyten në ujë.
- Mos i karikoni kufjet kur konektori ose priza është e lagur.
- Mos përdorni agjentë pastrimi që përmbajnë alkool, amoniak, benzinë, ose gërryes.
- Nëse nevojitet pastrim përdorni një leckë të butë, dhe nëse është e nevojshme, me pak ujë ose detergjent të lehtë të holluar për ta pastruar produktin.
- Bateria e integruar nuk duhet të ekspozohet ndaj nxehtësisë së tepërt siç është drita e diellit, zjarri ose të ngjashme.
- Rrezik shpërthimi nëse bateria është zëvendësuar në mënyrë të gabuar. Ndërroni vetëm me të njëjtin tip ose me tip ekuivalent.
- Për të arritur vlerësimin IP specifik, kapaku i hapësirës së karikimit duhet të jetë i mbyllur.
- Hedhja e baterisë në zjarr ose në furrë të nxehtë, ose shtypja mekanike apo prerja e baterisë, të cilat mund të shkaktojnë shpërthim.
- Lënia e baterisë në një ambient me temperaturë tepër të lartë mund të shkaktojë shpërthim ose rrjedhje të lëngjeve ose gazrave të djegshëm.
- Nëse bateria është nën presion atmosferik tepër të ulët, kjo mund të shkaktojë shpërthim ose rrjedhje të lëngjeve ose gazrave të djegshëm.

Temperaturat dhe lagështia gjatë përdorimit dhe ruajtjes


- Mbajeni në një vend ku temperatura është ndërmjet  $-20^{\circ}\text{C}$  dhe  $50^{\circ}\text{C}$  me deri në 90% lagështi relative.
- Përdoreni në një vend ku temperatura është ndërmjet  $0^{\circ}\text{C}$  dhe  $45^{\circ}\text{C}$  me deri në 90% lagështi relative.
- Jeta e baterisë mund të jetë më e shkurtër në temperatura të larta ose të ulëta.
- Ndërrimi i baterisë me një model të gabuar mund t'i dëmtojë rëndë kufjet dhe baterinë (për shembull, në rastin e disa baterive të litiumit).

## 2 Kufjet tuaja True Wireless

Urime për blerjen tuaj dhe mirësevini në Philips! Për të përfituar plotësisht nga mbështetja që jep Philips, regjistroni produktin në [www.philips.com/support](http://www.philips.com/support). Me këto kufje Philips True, ju mund:

- të bëni telefonata të rehatshme nëpërmjet valëve pa përdorur duart
- të dëgjoni dhe të kontrolloni muzikën me anë të valëve
- kaloni nga telefonata në muzikë ose anasjelltas

### Çfarë ka në kuti




Kufje Philips True Philips TAT8506



Maja Comply™ x 1 palë



Maja silikoni për veshët x 6 palë



Kablllo karikimi USB-C (vetëm për karikim)



Udhëzues i shkurtër



Garancia botërore






Fletëpalosje sigurie

### Pajisje të tjera

Një telefon celular ose pajisje portative (p.sh. laptop, tablet, adaptorë Bluetooth, aparate MP3) të cilat kanë Bluetooth dhe janë të pajtueshme me kufjet.

## Përmbledhje për kufjet tuaja True Wireless



- ① Prekje multi-funksionale (MFT)
- ② Treguesi LED (çiftimi me BT dhe rivendosja e parametrave të fabrikës)
- ③ Treguesi LED (kufjet)
- ④ Butoni i çiftimit me Bluetooth
- ⑤ Treguesi LED (gjendja e baterisë ose gjendja e karikimit)
- ⑥ Vendi i karikimit USB C

# 3 Fillimi


## Karikimi i baterisë

### Shënim

- Para se t'i përdorni kufjet, vendosini në kutinë e karikimit dhe karikojeni baterinë për 2 orë për të pasur kapacitet dhe jetëgjatësi optimale të baterisë.
- Përdorni vetëm kabllo origjinale USB-C karikimit për të shmangur dëmtimet.
- Mbaroni telefonatën para se t'i karikoni. Lidhja e kufjeve për t'i karikuar do t'i fikë ato.

## Kutia e karikimit

Lidheni njërën anë të kabllit USB-C në kutinë e karikimit dhe anën tjetër me burimin e energjisë.




### Këshillë

- Kutia e karikimit shërben si bateri rezervë portative për të karikuar kufjet. Kur kutia e karikimit është e karikuar plotësisht, ajo do t'i karikojë kufjet 3 herë.

## Kufjet

Vendosini kufjet në kutinë e karikimit.

- Kufjet fillojnë të karikohen dhe drita LED blu ndizet
- Kur kufjet të jenë të karikuara plotësisht, drita blu do të fiket



### Këshillë

- Normalisht, një karikim i plotë zgjat 2 orë (për kufjet ose për kutinë e karikimit) me kabllin USB.

## Karikimi me valë

(Karikuesi me valë nuk është i përfshirë)

Kutia e karikimit ka një bobinë të brendshme për karikim me valë. Mund ta karikoni baterinë duke përdorur një karikues me valë në një pajisje tjetër, e cila funksionon si karikues me valë.




### Kujdes

#### Masat paraprake për karikimin me valë

- Mos e vendosni kutinë e karikimit mbi karikuesin me valë kur midis kutsisë së karikimit dhe karikuesit me valë janë vendosur objekte metalike dhe magnetet.
- Mbajeni kutinë e karikimit larg nga temperaturat e larta dhe burimet e ujit. Kutia mund të nxeht gjatë karikimit. Kjo është normale.

Karikimi i baterisë me një karikues me valë.

- Vendosini kufjet në kutinë e karikimit
- Mbylleni kapakun e kutsisë së karikimit
- Vendoseni kutinë e karikimit në qendër të karikuesit me valë
- Kur janë të karikuara plotësisht, hiqeni kutinë e karikimit nga karikuesi me valë



### Këshillë


- Karikimi i plotë me valë zgjat 4 orë.

## Si vendoset

Zgjidhni maja të përshtatshme për qëndrim optimal


Qëndrimi i puthitur dhe i sigurt siguron cilësinë më të mirë të zërit dhe të anulimit të zhurmës.

- 1 Provoni cilat maja ju japin zërin më të mirë dhe rehatinë më të madhe.
- 2 Jepen 2 maja sfungjeri Comply™ dhe 5 masa të tjera majash silikon për veshët: ekstra të mëdha, të mëdha, mesatare, të vogla dhe ekstra të vogla.




### Vendosni kufjet

- 1 Kontrolloni orientimin majtas ose djathtas të kufjeve.
- 2 Vendosini kufjet në veshë dhe rrotullojini pak derisa t'i keni të futura mirë.



## Lidhja e kufjeve me pajisjen me Bluetooth për herë të parë

- 1 Sigurohuni që kufjet janë të karikuara plotësisht dhe të fikura.
- 2 Hapni kapakun e kutisë së karikimit. Mbani shtypur butonin e çiftimit për rreth 3 sekonda.



- ↳ Dritat LED në të dyja kufjet pulsojnë me radhë në ngjyrë të bardhë dhe blu
- ↳ Kufjet tani janë në modalitetin e çiftimit dhe janë gati për t'u çiftuar me një pajisje me Bluetooth (p.sh. një telefon celular).

- 1 Aktivizoni Bluetooth në pajisjen tuaj me Bluetooth.
- 2 Çiftojini kufjet me pajisjen tuaj me Bluetooth. Shikoni manualin e përdorimit të pajisjes me Bluetooth.



### Shënim

- Pasi t'i keni ndezur, nëse kufjet nuk gjejnë dot asnjë prej pajisjeve me Bluetooth të lidhura më parë, ato kalojnë automatikisht në modalitetin e çiftimit.

Shembulli i mëposhtëm tregon si t'i çiftoni kufjet me pajisjen tuaj me Bluetooth.

- 1 Aktivizoni funksionin Bluetooth të pajisjeve tuaja me Bluetooth dhe zgjidhni **Philips TAT8506**.
- 2 Vendosni kodin "0000" (4 zero) të kufjeve nëse kërkohet. Për ato pajisje që kanë Bluetooth 3.0 ose më të lartë, nuk ka nevojë të vendosni një kod.



**Philips TAT8506**

## Çiftimi i kufjeve me një pajisje tjetër me Bluetooth

Nëse doni që të çiftoni një pajisje tjetër me Bluetooth me kufjet, thjesht vendosini në modalitetin e çiftimit (shtypni butonin në kuti për 3 sekonda me të dyja kufjet brenda dhe hapeni kapakun), më pas gjeni pajisjen e dytë njëjloj si për çiftimin normal.



### Shënim

- Kufjet ruajnë 4 pajisje në memorie. Nëse përpiqeni të çiftoni me shumë se 4 pajisje, pajisja e çiftuar e para zëvendësohet me të fundit.

## Një kufje (modaliteti Mono)

Nxirreni kufjen e djathtë ose të majtë nga kutia e karikimit për përdorim Mono. Kufja do të ndizet automatikisht. Do të dëgjoni një zë nga kufjet që thotë "Power on".



### Shënim

- Nxirreni kufjen e dytë nga kutia e karikimit dhe ato do të çiftohen automatikisht me njëra-tjetrën.

## 4 Përdorimi i kufjeve

### Lidhini kufjet me pajisjen tuaj me Bluetooth

- 1 Aktivizoni Bluetooth në pajisjen tuaj me Bluetooth.
- 2 Hapni kapakun e kutisë së karikimit.
  - ↳ Drita LED pulson ngjyrë blu.
  - ↳ Kufjet do të kërkojnë pajisjen me Bluetooth me të cilën janë lidhur për herë të fundit dhe do të lidhen përsëri me të automatikisht. Nëse pajisja me të cilën është lidhur për herë të fundit nuk është e disponueshme, kufjet përpiqen të lidhen përsëri me pajisjen e lidhur për herë të parafundit.



#### Këshillë

- Nëse aktivizoni funksionin e pajisjes suaj me Bluetooth pasi i keni nderur kufjet, duhet të shkoni në menynë e Bluetooth të pajisjes dhe t'i lidhni manualisht kufjet me pajisjen.



#### Shënim


- Nëse kufjet nuk lidhet me asnjë pajisje Bluetooth brenda 3 minutash, ajo do të fiket automatikisht për të kursyer baterinë.
- Në disa pajisje me Bluetooth, lidhja mund të mos jetë automatike. Në këtë rast, duhet të shkoni në menynë Bluetooth të pajisjes dhe t'i lidhni manualisht kufjet me pajisjen me Bluetooth.
- Nëse nuk merret asnjë sinjal (muzikë/telefonatë) për 60 min edhe me lidhjen me Bluetooth, kufjet do të fiken automatikisht për të kursyer baterinë.

## Kontrolli ANC (anulimi aktiv i zhurmës)

### Aktivizimi i ANC

Modalitetet e ndryshme ANC mund të ndryshohen duke shtypur dy herë në kufjen e djathtë.

- Funksioni ANC aktivizohet automatikisht kur kufja futet në vesh
- Prekni dy herë MFT, ato do të kalojnë në modalitetin e vetëdijes
- Prekni përsëri dy herë MFT, funksioni ANC do të fiket



#### Këshillë

- Heqja e kufjeve do të aktivizojë automatikisht modalitetin e gjumit. Kur i vendosni përsëri kufjet, ato do të kthehen në modalitetin aktiv.

| Detyra                 | MFT             | Funksionimi                     |
|------------------------|-----------------|---------------------------------|
| ANC është nderur       | Kufja e djathtë | Dy shtypje                      |
| Modaliteti i vetëdijes | Kufja e djathtë | Dy shtypje                      |
| ANC e fikur            | Kufja e djathtë | Dy shtypje                      |
| Vetëdija e shpejtë     | Kufja e djathtë | Vazhdoni të prekni pas sinjalit |

## Ndezja/fikja

| Detyra          | MFT | Funksionimi                                                  |
|-----------------|-----|--------------------------------------------------------------|
| Ndizini kufjet  |     | Nxirrini kufjet nga kutia e karikimit për t'i ndezur         |
| Fikja e kufjeve |     | Vendosini përsëri kufjet në kutinë e karikimit për t'i fikur |

## Kontrollimi i telefonatave dhe muzikës

Kontrolli i muzikës

| Detyra                    | MFT             | Funksionimi                   |
|---------------------------|-----------------|-------------------------------|
| Luani ose ndaloni muzikën | Kufja e djathtë | Mbajeni shtypur për 1 sekondë |
| Kënga tjetër              | Kufja e djathtë | Tri shtypje                   |
| Ndrysho volumin +/-       |                 | Kontroll me anë të celularit  |

Kontrolli i telefonatës

| Detyra                                                | MFT             | Funksionimi                   |
|-------------------------------------------------------|-----------------|-------------------------------|
| Përgjigju / Ndrysho telefonuesin gjatë një telefonate | Kufja e djathtë | Dy shtypje                    |
| Mbyll telefonatën / Refuzo telefonatën                | Kufja e djathtë | Mbajeni shtypur për 1 sekondë |

## Asistenti me zë

| Detyra                                  | Butoni        | Funksionimi                   |
|-----------------------------------------|---------------|-------------------------------|
| Aktivizo asistentin me zë (Siri/Google) | Kufja e majtë | Mbajeni shtypur për 2 sekonda |
| Ndalo asistentin me zë                  | Kufja e majtë | Një shtypje                   |

## Përdorni funksionin Voice Assistant (nëpërmjet Google App)

Para se të përdorni këtë funksion, ju lutem instaloni Google App në smartfonin tuaj Android.



### Shënim

- Mund të kërkohet versioni më i fundit i aplikacionit.
- Për hollësi lidhur me Google App, ju lutem shikoni udhëzimet e përdorimit ose faqen e internetit të smartfonit Android, ose faqen e internetit të Google Play.
- Google App mund të mos aktivizohet nga kufjet në varësi të specifikimeve të smartfonit Android.

| Detyra                          | Prekje multi-funksionale | Funksionimi                  |
|---------------------------------|--------------------------|------------------------------|
| Aktivizo Google Voice Assistant | Kufja e majtë            | Vazhdo prekjen gjatë bisedës |
| Anulo Google Voice Assistant    | Kufja e majtë            | Një shtypje                  |
| Dëgjo njoftimin                 | Kufja e majtë            | Dy shtypje                   |

## Statusi tregues LED i kufjeve

| Statusi i kufjeve                                                          | Treguesi                                                                   |
|----------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------|
| Kufjet janë të lidhura me një pajisje me Bluetooth                         | Drita LED e bardhë pulson çdo 5 sekonda                                    |
| Kufjet janë gati për çiftim                                                | Drita LED pulson ngjyrë blu dhe të bardhë me radhë                         |
| Kufjet janë të ndezura por nuk janë të lidhura me një pajisje me Bluetooth | Drita LED e bardhë pulson çdo sekondë (fiket automatikisht pas 3 minutash) |
| Niveli i baterisë është i ulët (kufja)                                     | Drita LED blu pulson dy herë çdo 5 sekonda                                 |
| Bateria është e karikuar plotësisht (kutia e karikimit)                    | Shikoni dritën LED të kasës                                                |

## Drita treguese LED e kutisë së karikimit

| Gjatë karikimit                             | Treguesi                      |
|---------------------------------------------|-------------------------------|
| Bateria e ulët                              | Drita LED portokalli ndizet   |
| Bateria në gjendje relative                 | Drita LED e bardhë ndizet     |
| <b>Në përdorim dhe kapaku është i hapur</b> | <b>Treguesi</b>               |
| Bateria e ulët                              | Pulson portokalli për 4 cikle |
| Bateria në gjendje relative                 | Fikur                         |

## 5 Rivendosja e parametrave të fabrikës në kufje

Nëse hasni ndonjë problem me lidhjen, mund të ndiqni procedurën e mëposhtme për të bërë rivendosjen e të dhënave të fabrikës në kufje.

- 1 Në pajisjen tuaj me Bluetooth, shkoni te menuja e Bluetooth dhe fshijeni **Philips TAT8506** nga lista e pajisjeve.
- 2 Çaktivizoni Bluetooth në pajisjen tuaj me Bluetooth.
- 3 Kthejini kufjet në kutinë e karikimit dhe hapeni kapakun.
- 4 Shtypni butonin në kuti dy herë.
- 5 Ndiqni hapat në "Përdorimi i kufjeve - Lidhja e kufjeve me pajisjen tuaj me Bluetooth".
- 6 Lidhni kufjet me pajisjen tuaj me Bluetooth, zgjidhni **Philips TAT8506**.

Nëse nuk ka asnjë përgjigje nga kufjet, mund të ndiqni hapat e mëposhtëm për të rivendosur harduerin e kufjeve.

- Shtypni dhe mbani shtypur butonin multifunksional për 10 sekonda.

## 6 Të dhëna teknike

- Koha e luajtjes së muzikës (ANC aktive): 8 + 24 orë
- Koha e luajtjes së muzikës (ANC joaktive): 9 + 27 orë
- Koha në pritje: 200 orë
- Koha e karikimit: 2 orë
- Bateri Lithium-ion 55 mAh në secilën kufje. Bateri Lithium-ion 600 mAh në kutinë e karikimit
- Versioni i Bluetooth: 5.2
- Profili e pajtueshme Bluetooth:
  - HFP (Profili i përdorimit pa duar)
  - A2DP (Profili i avancuar i shpërndarjes së audios)
  - AVRCP (Profili i kontrollit në distancë të audios dhe videos)
- Audio codecs që mbështeten: LDAC, AAC, SBC
- Rrezja e frekuencave: 2.402-2.480 GHz
- Fuqia e transmetuesit: < 10 dBm
- Distanca e funksionimit: Deri në 10 metra
- Fije automatike e rrymës
- Portë USB-C për karikim
- Karikimi me valë
- Paralajmërim për bateri të ulët: disponohet



### Shënim

- Specifikimet janë objekt ndryshimi pa njoftim.

# 7 Njoftim

## Deklarata e konformitetit

Me anë të kësaj, MMD Hong Kong Holding Limited deklaron se ky produkt është në përputhje me kërkesat themelore dhe me dispozitat e tjera përkatëse të Direktivës 2014/53/EU. Mund ta gjeni deklaratën e konformitetit në [www.p4c.philips.com](http://www.p4c.philips.com).

## Hedhja e produktit dhe e baterisë së vjetër



Produkti është projektuar dhe prodhuar me materiale dhe komponentë të cilësisë së lartë të cilët mund të riciklohen dhe ripërdoren.



Ky simbol mbi produktin do të thotë se produkti mbulohet nga Direktiva Evropiane 2012/19/EU.




Ky simbol do të thotë se produkti përmban një bateri të karikueshme të mbuluar nga Direktiva Evropiane 2013/56/EU, e cila nuk mund të hidhet bashkë me mbetjet e zakonshme shtëpiake. Ju këshillojmë fort që ta çoni produktin në një pikë zyrtare grumbullimi ose në një qendër servisi Philips në mënyrë që bateria e karikueshme të hiqet nga një profesionist. Informohuni në lidhje me sistemin e veçantë lokal për grumbullimin e produkteve elektrike dhe elektronike dhe të baterive të karikueshme. Ndiqni rregullat lokale dhe asnjëherë mos e hidhni produktin dhe bateritë e karikueshme bashkë me mbetjet e zakonshme shtëpiake. Hedhja e duhur e produkteve të vjetra dhe baterive të karikueshme ndihmon në parandalimin e pasojave negative ndaj mjedisit dhe shëndetit të njeriut.


## Heqja e baterisë së brendshme

Nëse në vendin tuaj nuk ka sistem grumbullimi/riciklimi për produkte elektronike, mund ta mbronj mjedisin duke e hequr dhe ricikluar baterinë para se t'i hidhni kufjet.

- Sigurohuni që kufjet të jenë të shkëputura nga kutia e karikimit para se të hiqni baterinë.



- Sigurohuni që kutia e karikimit të jetë e shkëputur nga kabli USB i karikimit para se të hiqni baterinë.



---

## Pajtueshmëria me EMF

Ky produkt përputhet me të gjitha standardet dhe rregulloret përkatëse në lidhje me ekspozimin ndaj fushave elektromagnetike.

---

## Informacione mjedisore

Të gjitha paketimet e panevojshme janë hequr. Jemi përpjekur ta bëjmë paketimin të lehtë për t'u ndarë në tre materiale: karton (kutia), shkumë polisteroli (amortizatori) dhe polietilen (qeset, fleta e shkumës mbrojtëse.) Sistemi përbëhet nga materiale që mund të riciklohen dhe ripërdoren nëse çmontohen nga një kompani e specializuar. Ju lutemi të respektoni rregulloret vendëse në lidhje me hedhjen e materialeve të paketimit, baterive të konsumuara dhe pajisjeve të vjetra.

---

## Njoftimi për pajtueshmërinë

Pajisja përputhet me rregullat FCC, pika 15. Përdorimi u nënshtrohet dy kushteve të mëposhtme:

1. Kjo pajisje nuk duhet të shkaktojë interferencë të dëmshme, dhe
2. Kjo pajisje duhet të pranojë çdo interferencë të marrë, duke përfshirë interferencën që mund të shkaktojë përdorim të padëshiruar.

### Rregullat FCC

Kjo pajisje është testuar dhe është gjetur se u përmbahet limiteve për një pajisje dixhitale të Klasës B, sipas pikës 15 të rregullave FCC. Këto limite janë caktuar për të siguruar mbrojtje të arsyeshme ndaj interferencave të dëmshme në një ambient rezidencial. Kjo pajisje gjeneron, përdor dhe mund të rrezatojë energji të frekuencës radio dhe, nëse nuk është instaluar dhe përdorur në përputhje me manualin e udhëzimeve, mund të shkaktojë interferencë të dëmshme ndaj

komunikimeve radio. Sidoqoftë, nuk ka garanci që interferenca nuk do të ndodhë në një instalim të caktuar. Nëse kjo pajisje shkakton interferencë të dëmshme ndaj sinjalit të radios ose televizionit, gjë e cila mund të përcaktohet duke e ndezur dhe fikur pajisjen, përdoruesi inkurajohet që të përpiqet ta ndreqë interferencën nëpërmjet një ose më shumë prej masave të mëposhtme:

- Ndryshoni drejtimin ose vendin e antenës
- Largojeni pajisjen nga marrësi
- Lidheni pajisjen në një prizë në një qark të ndryshëm nga ai me të cilin është lidhur marrësi
- Flisni me shitësin ose me një teknik radioje/televizori, i cili ka eksperiencë, për ndihmë.

### Deklarata e FCC për ekspozimin ndaj rrezatimit:

Pajisja përputhet me kufijtë e FCC për ekspozimin ndaj rrezatimit të parashikuar për mjediset e pakontrolluara.

Ky transmetues nuk mund të vendoset ose përdoret së bashku me një antenë ose transmetues tjetër.

**Kujdes:** Përdoruesit i tërhiqet vëmendja se ndryshimet ose modifikimet e pamiratuara shprehimisht nga pala përgjegjëse për pajtueshmërinë mund ta bëjë të pavlefshëm autoritetin e përdoruesit për ta përdorur pajisjen.

### Kanada:

Kjo pajisje përmban transmetues/marrës pa licencë që përputhen me RSS-në pa licencë të Kanadasë për inovacionin, shkencën dhe zhvillimin ekonomik. Përdorimi u nënshtrohet dy kushteve të mëposhtme: (1) Kjo pajisje nuk duhet të shkaktojë interferencë. (2) Kjo pajisje duhet të pranojë çfarëdo interference, duke përfshirë interferencat që mund të shkaktojnë punim të padëshiruar të pajisjes.

**Deklarata IC për ekspozimin ndaj  
rrezatimit:**

Pajisja përputhet me kufijtë Kanadasë  
për ekspozimin ndaj rrezatimit, që janë  
përcaktuar për mjediset e  
pakontrolluara.

Ky transmetues nuk mund të vendoset  
ose përdoret së bashku me një antenë  
ose transmetues tjetër.

## 8 Markat tregtare

---

### Bluetooth

Fjala e markës dhe logot e Bluetooth® janë marka të regjistruara tregtare të zotëruara nga Bluetooth SIG, Inc. dhe çdo përdorim i këtyre markave nga MMD Hong Kong Holding Limited bëhet me licencë. Markat e tjera tregtare dhe emrat e tjerë tregtarë u përkasin pronarëve të tyre përkatës.

---

### Siri

Siri është një markë tregtare e Apple Inc., e regjistruar në SHBA dhe në vende të tjera.

---

### Google

Google dhe Google Play janë marka tregtare të Google LLC.

## 9 Pyetje të bëra shpesh

### **Kufjet e mia me Bluetooth nuk ndizen.**

Niveli i baterisë është i ulët. Karikoni kufjet.

### **Nuk i çiftoj dot kufjet e mia me Bluetooth me pajisjen time me Bluetooth.**

Bluetooth është çaktivizuar. Aktivizoni Bluetooth në pajisjen tuaj me Bluetooth dhe ndizeni pajisjen me Bluetooth para se të ndizni kufjet.

### **Çiftimi nuk punon.**

- Vendosini të dyja kufjet në kutinë e karikimit.
- Sigurohuni që të keni çaktivizuar Bluetooth të çdo pajisjeje tjetër me Bluetooth me të cilën jeni lidhur më përpara.
- Në pajisjen tuaj me Bluetooth, fshini "Philips TAT8506" nga lista e Bluetooth.
- Çiftoni kufjet (shikoni "Çiftimi i kufjeve me pajisjen Bluetooth për herë të parë" në faqen 6).

### **Pajisja me Bluetooth nuk i gjen dot kufjet.**

- Kufjet mund të jenë lidhur me një pajisje të çiftuar më parë. Fikeni pajisjen e lidhur ose largojini jashtë rrezes.
- Çiftimi mund të jetë fshirë ose kufjet janë çiftuar më parë me një pajisje tjetër. Çiftojini përsëri kufjet me pajisjen me Bluetooth siç tregohet në manual. (shikoni "Çiftimi i kufjeve me pajisjen Bluetooth për herë të parë" në faqen 6).

**Kufjet e mia me Bluetooth janë të lidhura me një telefon celular me Bluetooth stereo, por muzika luhet vetëm në boksën e telefonit celular.**

Shikoni manualin e përdorimit të telefonit celular. Zgjidhni të dëgjoni muzikë përmes kufjeve.

### **Cilësia e audios është e dobët dhe mund të dëgjohet zhurmë e çjerrë.**

- Pajisja me Bluetooth është jashtë rrezes. Afroni kufjet dhe pajisjen Bluetooth, ose largoni pengesat mes tyre.
- Karikoni kufjet.

### **Cilësia e audios është e dobët kur transmetimi nga celulari është shumë i ngadaltë ose transmetimi nuk punon fare.**

Sigurohuni që telefoni celular mbështet jo vetëm (mono) HSP/HFP, por mbështet edhe A2DP dhe është i pajtueshëm me BT4.0x (ose më i lartë) (shiko "Të dhëna teknike" në faqen 11).



SHKARKIMI I APLIKACIONIT  
Skanoni kodin QR/shtypni butonin  
"Download" ose kërkoni "Philips  
Headphones" në Apple App Store ose  
Google Play për ta shkarkuar aplikacionin.



2021 © MMD Hong Kong Holding Limited. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Specifikimet janë objekt ndryshimi pa njoftim. Philips dhe Philips Shield Emblem janë marka të tregtare të regjistruara të Koninklijke Philips N.V. dhe përdoren me licencë. Ky produkt është prodhuar dhe shitet nën përgjegjësinë e MMD Hong Kong Holding Limited ose të një prej filialeve të tij, dhe MMD Hong Kong Holding Limited është garantuesi në lidhje me këtë produkt. Të gjitha emrat e kompanive dhe produkteve të tjera mund të jenë marka tregtare të kompanive të tyre përkatëse.

